

**Raport Monitorimi i Realizmit të
Planeve të Integritetit të Njësive të
Vetëqeverisjes Vendore për Vitin 2023**

Table of Contents

I. Hyrje.....	3
II. Metodologjia e vlerësimit.....	4
III. Monitorimi i zbatueshmërisë së planeve të integritetit	8
IV. Vlerësim i impaktit të zbatueshmërisë së masave të planit të integritetit.....	10
IV.1 Krahasimi mes shkallës së zbatueshmërisë dhe impaktit të planeve të integritetit	12
IV. Konkluzione dhe Rekomandime.....	13
Shtojca	14

Lista e Figurave

Figura 1: Shkalla e realizimit të plotë të masave/aktivitetëve sipas planeve të integritetit, 2023	9
Figura 2: Objektivi I. Forcimi i sistemit të integritetit në bashki duke siguruar një kuadër të brendshëm rregullator pro-integritet;	10
Figura 3: Objektivi II - Rritja e efikasitetit të sistemit të integritetit në bashki përmes menaxhimit efektiv të burimeve njerëzore dhe financiare.....	11
Figura 4: Objektivi III: Forcimi i transparencës, efikasitetit sipas fushave të përgjegjësisë dhe llogaridhënies publike të bashkisë;	11
Figura 5: Shkalla e realizimit kundrejt vlerësimit të ndikimit të masave në integritet	12
Figura 6: Lidhja mes Shkallës së zbatimit të planit të integritetit dhe integritetit institucional .	12

Lista e Tabelave

Tabela 1: Indikatorë të vlerësimit të forcimit të sistemit të integritetit.....	6
Tabela 2: Indikatorë të vlerësimit të mirë-menaxhimit dhe forcimit të integritetit	6
Tabela 3: Indikatorë të vlerësimit të transparencës në forcimin e integritetit.....	7
Tabela 4: Shkalla e vlerësimit të impaktit sipas objektivave të planit të integritetit	8

I. Hyrje

Integriteti institucional dhe lufta kundër korrupsionit konsiderohen si një nga prioritetet kryesore të qeverisë shqiptare. Në kontekstin e sektorit publik, integriteti konsiston në përmbushjen e detyrimeve të transparencës, llogaridhënies, etikës, ndershmërisë, efektivitetit dhe efikasitetit në kryerjen e detyrave dhe të ushtrimit të funksioneve rregullatore dhe administrative.

Miratimi dhe monitorimi i politikave kundër korrupsionit në nivelin e qeverisjes vendore është jetësuar nëpërmjet koordinimit dhe zbatimit të nismave anti-korrupsion të parashikuara në Strategjinë Ndërsëktoriale Kundër Korrupsionit (SNKK) 2015-2023.... Ndërkohë menaxhimi i riskut të integritetit për NJVV-të, si proces në vetëvete rrjeth nga objektivi specifik (objektivi A11) i SNKK dhe Planit të Veprimit (2018-2023), miratuar me VKM nr.516, datë 1.7.2020 dhe qëllimit politik 5 të i SNDQV - objektivi specifik 5.2: Nxitja e politikave kundër korrupsionit në nivel vendor dhe konsolidimi i mëtejshëm i arritjeve mbi integritetin. miratuar me VKM nr.252, datë 21.04.2023". Ky Proces vjen në linjë edhe me rekomandimet e Komisionit Evropian (2018) për Shqipërinë në kuadër të procesit të integritetit në Bashkimin Evropian, ku një nga rekomandimet e dhëna është zbatimi i dokumentit të Strategjisë Kundër Korrupsionit.

Duke i'u referuar nivelit vendor, nevoja për të forcuar në mënyrë të vazhdueshme sistemet e menaxhimit të integritetit në kuadër të thellimit të thellimit të procesit të decentralizimit është evidente. Procesi i decentralizimit i shërben forcimit të llogaridhënies duke e sjellë qeverinë më afër qytetarëve. Ndërkaq i zbatuar në shërbimet publike, për shkak të rritjes së kontakteve midis zyrtarëve vendorë dhe qytetarëve, ky proces mund të decentralizojë edhe shfaqjen apo mundësinë të shfaqjes së risqeve të integritetit, duke penguar zvogëlimin apo eliminimin e plotë të tyre, gjë që bën të domosdoshme marrjen e masave menaxhuese proaktive ndaj këtyre rrisqeve. Në këtë kontekst hartimi i planeve të integritetit dhe planeve përkatëse të veprimit nga Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore (NJVV) dhe monitorimi i realizimit të tyre ofrojnë kuadrin konceptual për politikën dhe masat për parandalimin e shkeljeve të integritetit të zyrtarëve publikë.

Menaxhimi i integritetit institucional dhe monitorimi si hallkë përbërëse e tij synojnë të ndihmojnë politikbërësit, administratat vendore dhe drejtuesit e shoqërisë civile për të përmirësuar kontrollin ndaj korrupsionit në shoqëritë dhe komunitete të tyre. Monitorimi i vazhdueshëm i zbatimit të Planit të Integritetit si një etapë e rëndësishme e ciklit të menaxhimit të risqeve të integritetit i'u mundëson bashkive të shohin potencialin e tyre për përmirësim në fusha specifike të veprimtarisë së njësisë vendore. Një analizë rigoroze e këtyre fushave ndihmon në zhvillimin e strategjive të bazuara në evidenca dhe ndërmorjen e veprimeve dhe masave konkrete për të prandaluar ose zvogëluar korrupsionin, duke garantuar qeverisje të mirë dhe efikase.

Procesi i menaxhimit të riskut të integritetit ka një qasje gjithëpërfshirëse ku angazhohen të gjitha strukturat e brendshme të bashkisë. Ndërsa hapi i parë i tij lidhet me hartimin e Planit të integritetit (detajuar ky i fundit edhe me një plan veprimi 3-vjeçar), monitorimi dhe raportimi i planit të integritetit është etapa tjetër e menaxhimit të riskut në bashki. Raportimi është një procedurë e rregullt që do të sigurojë zbatimin e Planit të Veprimit për risqet e integritetit sipas afateve kohore të parashikuara.

II. Metodologjia e vlerësimit

Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore (AMVV) në kuadër të funksioneve të saj për realizimin e objektivave të Qeverisë Shqiptare për garantimin e qeverisjes së mirë, ka vijuar me procesin e monitorimit të zbatimit të planeve të integritetit në nivel bashkie për vitin 2023. Për realizimin e procesit të monitorimit të realizimit të planeve të integritetit të bashkive gjatë vitit 2023, AMVV ka koordinuar punën me Njësitë e Qeverisjes Vendore (NJQV) që kanë miratuar tashmë një Plan Integriteti. Analiza e të dhënave dhe vlerësimi i progresit të zbatimit të Planit të veprimit të Planit të Integritetit të bashkive është bërë në zbatim të Urdhrit nr. 553, datë 30.09.2021 *“Për miratimin e metodologjisë së monitorimit të Planit të Integritetit për institucionet qendrore”*. Raporti i monitorimit janar-dhjetor 2023, për zbatimin e Planit të Integritetit për bashkitë të cilat e kanë miratuar atë gjatë vitit 2022 si dhe ato që e kanë një plan veprimi për vitin 2023, përmban një analizë të përgjithshme për realizimin e masave/aktiviteteve të parashikuar për secilën fushë të planifikuar në planin e veprimit të planeve të integritetit për periudhën e kërkuar. Ky raport realizimi jep të dhëna për statusin e zbatimit të hartimit dhe plotësimit të kuadrit të brendshëm rregullator mbi etikën dhe integritetin, burimeve njerëzore të qëndrueshme dhe profesionale, transparencës, si dhe menaxhimit të riskut të integritetit në fusha të vecanta të përgjegjësisë.

Në këtë kontekst janë hartuar Raportet e Monitorimit të realizimit të Planeve të Veprimit të Planeve të Integritetit të bashkive, Tiranë, Himarë, Shijak, Maliq, Pogradec, Kukës, Bulqizë, Lezhë, Belsh, Durrës, Has, Roskovec, Puka, Kavajë, Përmet dhe Berat. Raportet e monitorimit të bashkive gjenden bashkëngjitur këtij raporti dhe publikohen në ëbsitet e bashkive dhe në atë të AMVV-së. Të dhënat e hartimit të këtij raporti janë mbledhur dhe raportuar nga koordinаторët e Integritetit të Njësisë e Vetëqeverisjeve Vendore. Monitorimi i zbatimit të Planeve të veprimit të Planeve të integritetit është bazuar në metodologjinë e hartuar nga Ministria e Drejtësisë (add reference)

Kjo metodologji bazohet në planet e veprimit të planit të integritetit si bazë dhe në raportimin për cdo masë të këtij plani raportohen:

1. Hapat e ndërmarrë në zbatim të masës/aktivitetit (periudhnën kohore, dokumentat e hartuara, proceset e ndjekura në mënyrë të vecantë ato konsultative)
2. Masën e realizimit të masës/aktivitetit, (në %, të bazuar në evidencat e raportuara)
3. Hartimin dhe raportimin e indikatorëve të ndikimit të masës/aktivitetit,
4. Problematikat e hasura, në të cilën të përfshihen edhe pengesa të brendshme apo të jashtme, me karakter ligjor, nënligjor, rregullator, apo njerëzor në realizimin e planit të integritetit;
5. Të dhëna mbi burimet financiare të alokuara për realizimin të masave të planit të integritetit
6. Rekomandime, për përmirësimin e realizimit dhe impaktit të masave të integritetit

Sa më sipër ky raport analizon të dhënat si më poshtë:

- 🚩 Shkallën e realizimit të objektivave nëpërmjet analizës së raportimit të masave dhe aktiviteteve krahasimisht për të gjitha Bashkitë
- 🚩 Analizën e procesit të zbatimit të masave/aktiviteteve duke identifikuar ndikimin e këtyre masave në integritetin e institucioneit
- 🚩 Paraqitjen e treguesve të ndikimit të këtyre masave në arritjen e objektivave të planit të integritetit

Zbatueshmëria e masave dhe aktiviteteve klasifikohet me vlerat si më poshtë:

- E realizuar: Bashkitë kanë raportuar statusin e realizuar për ato masa dhe aktivitete të cilat janë përmbushur
- Pjesërisht e realizuar/në proces: Bashkitë kanë raportua statusin “Në proces” për ato masa/aktivitete të cilat në peridhën e raportimit kanë pasur zbatim të pjesshëm apo që vijojnë të jenë në zbatueshmëri prej tyre.
- E parealizuar; Të pazbatuar janë raportuar ato masa aktivitete të cilat nuk kanë regjistruar zhvillim për perudhën raportuese apo që nuk është dhënë raportim nga strukturat përgjegjëse për zbatim.

Në fund të analizës shkalla e zbatimit të të Planit të integritetit do të vlerësohet më një tregues të përgjithshëm i cili përmbledh vlerësimin sipas objektivave duke i dhënë peshë të barabartë secilit objektiv. Në këtë mënyrë treguesi i vlerësimit të zbatueshmërisë së PI në bashki varion nga 0% deri në 100% duke vlerësuar shkallën e zbatueshmërisë. Nga ana tjetër duke qenë se monitorimi i kryer është cilësor dhe jo sasior ndarja në nivele vlerësimi i Planeve të integritetit nuk është matematikisht uniforme.

Rezultatet e raporteve të monitorimit përmbledhen në tabelën e mëposhtme ku janë vendosur numri total i masave, numri i masave të realizuara, numri i masave në proces dhe numri i masave të parealizuara për çdo bashki. Gjithashtu për secilën nga njësitë vendore është kryer edhe llogaritja në përqindje e masave të realizuara, në proces dhe të parealizuara:

% e masave të realizuara = numri i masave të realizuara / nr total i masave të planifikuara për vitin 2023 për bashkinë

% e masave në proces = numri i masave në proces / nr total i masave të planifikuara për vitin 2023 për bashkinë

% e masave të parealizuara = numri i masave të parealizuara / nr total i masave të planifikuara për vitin 2023 për bashkinë

Shkalla e realizimit të planeve të integritetit për 16 bashkitë vlerësohet mbi totalin e masave si % e masave të realizuara kundrejt masave totale.

% e masave të realizuara për 16 bashkitë e monitoruara = shuma e numrit të masave të realizuara për të gjitha bashkitë/ shumën e masave të planifikuara për vitin 2023 për të gjitha bashkitë

Indikatorët e performancës në një plan integritetit në qeverisjen vendore varen nga qëllimet dhe objektivat specifike të planit të caktuar, në rastin tonë konkret mund ti përmbledhim në 3 objektiva kryesorë që janë:

- ❖ *Froçimi i sistemit të integritetit në bashki duke siguruar një kuadër të brendshëm rregullator pro-integritet;*
- ❖ *Rritja e efikasitetit të sistemit të integritetit në bashki përmes menaxhimit efektiv të burimeve njerëzore dhe financiare;*
- ❖ *Forcimi i transparencës, efikasitetit sipas fushave të përgjegjësisë dhe llogaridhënies publike të bashkisë;*

Raporti i monitorimit përfshin dhe një analizë të ndikimit të planit të integritetit në arritjen e objektivave. Indikatorët që janë ndërtuar për të vlerësuar shkallën e arritjes së objektivit të forcimit

të integritetit përfshijnë elementë të përmirësimit të kuadrit rregullator dhe krijimit të strukturave institucionale në funksion të forcimit të integritetit.

Indikatorët vlerësojnë nëse bashkia ka hartuar rregullore/akte të brendshme për menaxhimin e situatave që mbartin risk për të krijuar akte korruptive, konflikt interesi apo sjellje jo-etike. Bashkitë do të vlerësohen pozitivisht nëse kanë konsoliduar kudrin rregullativ të forcimit të integritetit, kanë ndërtuar struktura si dhe kanë zhvilluar një qasje strategjike mbi aspekte të parandalimit të konfliktit të interesit, menaxhimit të risqeve dhe forcimit të integritetit. (shih tabelën 1)

Tabela 1: Indikatorë të vlerësimit të forcimit të sistemit të integritetit

Objektivi I. Focimi i sistemit të integritetit në bashki duke siguruar një kuadër të brendshëm rregullator pro-integritet;	Pikezimi
Bashkia ka Kod Sjellje/ Etike të miratuar dhe publikuar (ose kapitull mbi etiken në rregulloren e brendshme)	5
Bashkia ka rregullore (bazuar në Nenin 46 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005) “Për parandalimin e konfliktit të interesave.	5
Në aktet e brendshme të bashkisë, ka dispozita që rregullojnë marrjen dhe raportimin e dhuratave për punonjësit e bashkisë dhe këshilli bashkiak.	5
Bashkia ka rregullore të brendshme për procedurën e hetimit administrativ të sinjalizimit.	5
Bashkia ka ngritur një strukturë të brendshme (grup pune/koordinator) për zbatimin e planit të integritetit.	5
Bashkia ka trajtuar raste të masave që kanë ardhur si rezultat i sinjalizuesve;	5
Plani i integritetit për institucionin bazohet në analizën e risqeve ndaj integritetit dhe harton masa për menaxhimin e tyre;	5
Bashkia ka ngritur njësinë përgjegjëse që regjistron, heton administrativisht dhe shqyrton sinjalizimet për veprime ose praktika të dyshuara korruptive;	5
Bashkia ka hartuar raport monitorimi të zbatimit të Planit të Integritetit;	5

Për të vlerësuar rritjen e efikasitetit të sistemit të integritetit në bashki përmes mirë menaxhimit efektiv të burimeve njerëzore dhe financiare u identifikuan një sërë indikatorësh që tregojnë nëse bashkia ka ndërtuar sisteme monitorimi në funksion të mirë-menaxhimit të burimeve njerëzore dhe financiare, shërbimeve publike dhe integritetit. Ndër indikatorët e përdorur janë ato që vlerësojnë monitorimin e planit të integritetit, instrumenta të menaxhimit të burimeve njerëzore dhe financiare, menaxhimin e pronave publike, menaxhimin e shërbimeve publike të ofruara dhe këanqësisë së qytetarëve. (shih tabelën 2)

Tabela 2: Indikatorë të vlerësimit të mirë-menaxhimit dhe forcimit të integritetit

Objektivi II: Rritja e efikasitetit të sistemit të integritetit në bashki përmes menaxhimit efektiv të burimeve njerëzore dhe financiare	Pikëzimi
Bashkia ka përshkrime të punës për çdo pozicion në shërbimin civil.	5
Bashkia ka një sistem të vlerësimit të rezultateve në punë të nëpunësve civilë?	5
Bashkia ka një plan/program për kualifikimin dhe trajnimin e administratës të bazuar në nevojat e identifikuar të institucionit të bazuar në vlerësimin e performancës së stafit;	5
Bashkia dhe institucionet në varësi të saj nuk kanë rritur detyrime financiare të papaguara ndaj enteve kontraktore për punë, mallra dhe shërbime gjatë vitit të raportimit;	5

Vlera e raportit mes të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore të realizuara me ato të planifikuara është > xx%;	5
Raportin vjetor i shpenzimeve buxhetore fakt/shpenzimeve buxhetore plan është > 80%	5
Gjatë kontrolli të fundit të KLSH nuk janë raportuar dëme financiare;	5
Bashkia ka shërbime publike me sistemin e treguesve të performancës (përfshirë ato gjinor dhe aksesin e grupeve të cënueshme) si mekanizëm monitorimi dhe vlerësimi;	5
Bashkia ka strukturë përgjegjëse për mbikëqyrjen dhe monitorimin e performancës së shërbimeve publike të ofruara nga pushteti vendor;	5
Bashkia raporton monitorimeve/kontrolleve të bëra për zbatimin e kontratave të punëve publike;	5
Bashkia një strukturë të veçantë dhe strategji për menaxhimin e pronave dhe asetëve të saj?	5
Bashkia një bazë të integruar të dhënash (databazë) për pasuritë e paluajtshme përfshirë, por pa u kufizuar, sistemin e informacionit GIS dhe sistemin e menaxhimit financiar?	5
Bashkia ka një plan të përgjithshëm vendor të miratuar?	5
Bashkia ka plan strategjik për zhvillimin ekonomik vendor.	5
Ekziston një sistem i monitorimit të vazhdueshëm të kënaqësisë së qytetarëve me shërbimet e ofruara nga bashkia;	5

Një sërë indikatorësh monitorimi kanë vlerësuar ndikimin të planeve të integritetit në forcimin e transparencës institucionale dhe llogaridhënies, duke zvogëluar kështu hapësirat për keq përdorimin e pushtetit dhe ndërmarrjeve akteve jo-etike/apo korruptive. Ky grup indikatorësh përfshin elementë të transparencës në aspektin rregullativ, transparencë në hartimin e politikave lokale dhe në vecanti atyre të identifikuar si prioritet strategjike dhe të zhvillimit. Për shkak të rëndësisë që kanë procedurat e prokurimeve, punësimeve si dhe komunikimi me publikun elementë të transparencës përfshijnë publikimin e planit të prokurimit, planit të pranimave në shërbimin publik, raporte të audituesve si dhe përgjigjet ndaj kërkesave të marra nga publiku. (shih tabelën 4)

Tabela 3: Indikatorë të vlerësimit të transparencës në forcimin e integritetit

Objektivi III: Forcimi i transparencës, efikasitetit sipas fushave të përgjegjësisë dhe llogaridhënies publike të bashkisë;	Pikëzimi
Bashkia ka Program Transparencës të plotësuar dhe përditësuar;	5
Bashkia ka publikuar në faqen zyrtare Planin e Integritetit	5
Bashkia ka publikuar planin e zhvillimit strategjik	5
PBA (Programit Buxhetor Afatmesëm) është konsultuar me komunitetin dhe grupet e interesit;	5
Bashkia ka publikuar në faqen zyrtare “Raportin Vjetor të Monitorimit të buxhetit?”	5
Bashkia ka publikuar raportin më të fundit të auditit të brendshëm në faqen zyrtare internetit (ëeb) të bashkisë;	5
Bashkia ka plan vjetor, të miratuar dhe të publikuar për pranimin në shërbimin civil.	5
Bashkia ka shpallur vendet vakante për periudhën që po raportoni;	5
Bashkia ka zhvilluar seanca këshillimi për procedurat e tjetërsimit ose dhënies në përdorim të pronave të bashkisë të tretëve;	5
Bashkia ka publikuar në faqen zyrtare të internetit i kontakteve për koordinatoren e informimit;	5
Bashkia ka publikuar rregulloren e brendshme të miratuar;	5

Numri mesatar i ditëve për kthimin e përgjigjes ndaj kërkesave për informacion është më I vogël se 10 ditë pune;	5
Bashkia vë në dispozicion të publikut një faqe dinamike interneti ku ofrohet informacion i përditësuar dhe publiku informohet në kohë.	5
Është i publikuar regjistri i parashikimeve të prokurimit publik në faqen zyrtare në internet (faqja ëeb) të Bashkisë.	5
Është i publikuar në faqen zyrtare (ëeb site) të Bashkisë regjistri i realizimit të prokurimeve.	5

Indikatorët e realizuar (plotësuar nga bashkia) pikëzohen, me 5 pikë secili, dhe ndihmojnë në matjen e ndikimit të masave të planit të integritetit në arritjen e objektivave. Vlerësimi sipas indikatorëve arrin vlerën maksimale prej 200 pike, nderkohe distanca e një institucioni nga vlerësimi optimal tregon dhe shkallën e ndikimit të planit të integritetit si masë parandaluese antikorrupsion.

Indeksi i përgjithshëm i ndikimit të planit të integritetit është formuar si shumatore e vlerësimit të indikatorëve. Indikatorët e vlerësimit janë matës të thjeshtë, të formuluar si deklaratatë të cilat nëse janë të vërteta, bazuar në të dhënat e bashkisë vlerësohen me pikë, në të kundërt vlerësohen me zero. Evidencat për të pohuar ose mohuar indikatorët u mbledhën nga ekspertë të pavaruar duke përdorur programin e transparencës, raportet e monitorimit të buxheteve dhe performancës së bashkive, dokumentave strategjikë apo dhe rregulloreve dhe akteve administrative të brendshme (si psh regjistri i kërkesave, sinnjalizuesit etj). Bashkitë nëpërmjet masave të planeve të integritetit të zbatuara duhet të kenë përmirësuar transparencën, menaxhim dhe kuadër rregullativ në mbështetje të integritetit.

Tabela 4: Shkalla e vlerësimit të impaktit sipas objektivave të planit të integritetit

Objektivat e Planeve të Integritetit	Vlerësimi
Objektivi I: Forcimi i sistemit të integritetit në bashki duke siguruar një kuadër të brendshëm rregullator pro-integritet;	50
Objektivi II: Rritja e efikasitetit të sistemit të integritetit në bashki përmes menaxhimit efektiv të burimeve njerëzore dhe financiare	75
Objektivi III: Forcimi i transparencës, efikasitetit sipas fushave të përgjegjësisë dhe llogaridhënies publike të bashkisë;	75


III. Monitorimi i zbatueshmërisë së planeve të integritetit

Nga këto llogaritje sipas tabelës dhe së mëposhtme rezulton se në rang kombëtar Planet e Veprimit janë realizuar 58 %

Gjatë 2023 Bashkitë kanë treguar angazhim dhe dedikim në materializimin e planeve të integritetit dhe si rrjedhojë në zvogëlimin e risqeve të akteve jo-etike dhe korruptive. Shkalla e përgjithshme e realizimit të planeve të integritetit rezultoi në mesataren prej 58%. Shkallën më të lartë të realizimit të planeve të integritetit e raportojnë bashkitë e vogla, të përfshira herët në këtë proces dhe të mbështetura nga donatorët dhe shoqëria civile si Himara, Shijak, Maliq, Roskovec. Ndër bashkitë e mëdha kanë performuar më mirë bashkia e Tiranës dhe Pukës. Disa nga bashkitë e vogla

si Permeti, Hasi apo Kavaja kanë një progres të ngadaltë në numrin e masave të realizuara, megjithatë të dhënat tregojnë se këto bashki kanë ndërmarrë hapa të rëndësishëm në adresimin e kudrit rregullativ dhe forcimin e menaxhimit, ndërkohë që duhet të përmirësojnë aspekte të transparencës.

Figura 1: Shkalla e realizimit të plotë të masave/aktivitetëve sipas planeve të integritetit, 2023



Kështu nga monitorimi evidentohet përmirësimi i menaxhimit të burimeve njerëzore, miratimi i kodit të sjelljes si dhe plotësimi i programeve të transparencës, të cilat janë të publikuara në faqet zyrtare të NJVV-ve. Planet e integritetit kanë sjellë efektet e tjera pozitive në procedurat e prokurimeve publike, llogaridhënien dhe forcimin e rolit të audituesve të brendshëm, qartësimin e detyrave të personelit si dhe përmirësimin në menaxhimin financiar dhe transparencën me komunitetin veçanërisht në treguesit financiarë. Progres është konstatuar në ngritjen dhe funksionimin e njësive të sinjalizuesve, gjithashtu janë krijuar e plotësuar regjistrat për shmangien e konfliktit të interesit dhe ai për ankesat dhe kërkesat.


Monitorimi i zbatimit të masave specifike të përcaktuara në plane të integritetit është një mënyrë për të vlerësuar impaktet. Nëse masat zbatohen dhe zbatohen me efektivitet, ky është një tregues pozitiv i përparimeve në luftën kundër korrupsionit dhe përmirësimin e integritetit në nivel vendor.

IV. Vlerësim i impaktit të zbatueshmërisë së masave të planit të integritetit

Impakti i zbatimit të masave të planeve të integritetit u analizua sipas objektivave të synuara. Planet e integritetit (pavarësisht si i kanë të formuluar objektivat) kanë synuar të forcojnë kuadrin rregullativ me synim krijimin e kulturës organizative pro-integritet.

Bashkitë që kanë arritur të ndryshojnë aspekte të kuadrit rregullativ dhe të forcojnë kulturën pro-integritet janë bashkitë si ajo e Tiranës, Maliqit, Lezhe, Kukës. Indeks i vlerësimit të impaktit për keto bashki ka vlerë të lartë. Bashkitë që do duhet të forcojnë përpjekjet në aspektin e forcimit të frymës pro-integritet janë ato të Beratit, Belshit, Bukqizës, Durrës, Has dhe Kavajës. (shih Figurën

Figura 2: Objektivi I. Focimi i sistemit të integritetit në bashki duke siguruar një kuadër të brendshëm rregullator pro-integritet;



Më i dobet duket ndikimi i masave të planit të integritetit në menaxhimin me integritet të burimeve njerëzore dhe financiare. Masat e planeve të integritetit duhet të forcojnë lidhjen me mire-menaxhimin, edhe pse kjo lidhje është rrjedhojë e forcimit të kulturës organizative pro-integritet. Bashkitë të gjitha kanë nevojë të forcojnë integritetin në menaxhimin publik, por bashkitë që duhet të përmirësojnë ndjeshëm këtë aspekt janë ato të Bulqizës, Përmetit, Kavajës, Himarës, Durrësit dhe Beratit. (shih figurën 3)

Figura 3: Objektivi II - Rritja e efikasitetit të sistemit të integritetit në bashki përmes menaxhimit efektiv të burimeve njerëzore dhe financiare





Figura 4: Objektivi III: Forcimi i transparencës, efikasitetit sipas fushave të përgjegjësisë dhe llogaridhënies publike të bashkisë;




Një aspekt të rëndësishëm që ndikohet nga zbatueshmëria e planeve të integritetit janë transparencja dhe llogaridhënia. Zbatimi i planeve të integritetit ka forcuar transparencën dhe llogaridhënien në pothuajse të gjitha bashkitë, por ato që reflektojnë ndikim më të lartë janë bashkia e Bulqizës, Tiranës, Lezhës dhe Kukësit. Nëpërgjithësi Bashkitë e vogla, për shkak edhe të burimeve teknike (financiare dhe IT) kanë shkallë më të ulët të impaktit të zbatueshmërisë së planave të integritetit në nivelin e transparencës dhe llogaridhënisë.

IV.1 Krahësimi mes shkallës së zbatueshmërisë dhe impaktit të planeve të integritetit


Ne kemi krahasuar performancën e bashkive në realizimin e masave me indeksin që vlerëson ndikimin e këtyre masave në arritjen e objektivave dhe forcimin e integritetit. Bashkitë si Kavaja, Himara apo Durrësi nuk manifestojnë një reflektim të drejtë të përpjekjeve për të zbatuar planet e integritetit në përmirësimin e transparencës, kuadrit rregullator institucional apo praktikave më të mira të menaxhimit. Këto bashki pavarësisht se raportojnë një shkallë mesatare të zbatueshmërisë, kanë indeksin e vlerësimit të ndikimit të planeve të integritetit më të ulët. Bashkitë që reflektojnë ndikim të lartë të masave të zbatuara të planit të integritetit janë bashkia Lezhë dhe Tiranë, të ndjekura nga një sërë bashkish të vogla si ajo e Maliqit, Roskovecit, Shijakut dhe Pukës.

Figura 5: Shkalla e realizimit kundrejt vlerësimit të ndikimit të masave në integritet



Vlerësimi i korelacionit mes shkallës së zbatueshmërisë dhe indeksit të impaktit të planit të integritetit tregojnë se ka një përmirësim me 15 pikë përqindje në aspekte të integritetit institucional rritja me 1 pikë përqindje e shkallës së zbatueshmërisë së plotë të planit të integritetit. Lidhja pozitive mes zbatueshmërisë së masave të planit të integritetit dhe impaktit në forcimin e kulturës pro-integritet të institucioneve të pushtetit vendor konfirmon edhe njëherë se përpjekjet për të marrë masa preventive anti-korrupsion do të sjellin ndryshime pozitive.

Figura 6: Lidhja mes Shkallës së zbatimit të planit të integritetit dhe integritetit institucional



V. Konkluzione dhe Rekomandime

Nga monitorimi rezultoi se në bashki është vënë re një progres i qëndrueshëm për sa i përket parametrave të transparencës dhe të zbutjes së riskut të integritetit. Kështu nga monitorimi evidentohet përmirësimi i menaxhimit të burimeve njerëzore, risia e hartimit të planeve vjetore për kualifikimin dhe trajnimin e administratës bashkiake, miratimi i kodit të sjelljes si dhe plotësimi i programeve të transparencës, të cilat janë të publikuara në faqet zyrtare të NJVV-ve. Planet e integritetit kanë sjellë efektet të tjera pozitive në procedurat e prokurimeve publike, qartësimin e detyrave të personelit si dhe rritjen e transparencës me komunitetin veçanërisht në treguesit financiarë. Progres është konstatuar në ngritjen dhe funksionimin e njësive të sinjalizuesve, gjithashtu janë krijuar e plotësuar regjistrat për shmangien e konfliktit të interesit dhe ai për ankesat dhe kërkesat.

Disa aspekte që mund të merren për të përmirësuar integritetin në qeverisjen vendore për krijimin e një mjedisi pro-integritet dhe të përgjegjshëm për të gjithë qytetarët mund të jenë:

- Ndryshimet në strukturat institucionale në përputhje me rregullat e adoptuara të menaxhimit të konfliktit, etikës dhe sinjalizuesve.
- Krijimi dhe forcimi i mekanizmave të sigurisë dhe mbrojtjes së sinjalizuesve të rasteve të korrupsionit dhe abuzimeve duke inkurajuar njerëzit të denoncojnë;
- Sigurimi që informacioni publik të jetë lehtësisht i arritshëm dhe i përditësuar për qytetarët dhe përfaqësuesit e mediave është thelbësor për të siguruar llogaridhënie dhe transparencë në veprimtaritë e qeverisjes vendore
- Përdorimi i Indikatorëve të Performancës në fusha si shërbimet, menaxhimi i burimeve njerëzore e financiare dhe monitorimi i tyre ndihmon në identifikimin e problematikave dhe rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit të shërbimeve publike.
- Ndërgjegjësimi dhe Edukimi i Publikut: fushatat e ndërgjegjësimit dhe edukimit të publikut për rrezikun e korrupsionit dhe për rëndësinë e pjesëmarrjes aktive të qytetarëve në proceset vendimmarrëse janë të rëndësishme për të krijuar një kulturë të ndërgjegjshme dhe të integruar në shoqëri;

Shtojca

Shtojca 1: Shkalla e zbatueshmërisë së planeve të integritetit

N r	Bashkia	Nr. VKB	Data e miratimit	Status i aktual i raportit të monitorimit	Masa në total 2023 Janar-Dhjetor	Masa të realizuara plotësisht	Masa në proces realizimi	Masa të parealizuara	Masa të realizuara plotësisht në %	Masa në proces realizimi në %	Masa të parealizuara në %
1	Tiranë	35	06.04.2022	Hartuar	44	27	11	6	61%	25%	14%
2	Himarë	28	27.05.2022	Hartuar	52	34	4	14	65%	8%	27%
3	Shijak	20	07.06.2022	Hartuar	44	28	11	5	63%	25%	12%
4	Maliq	54	31.05.2022	Hartuar	54	34	11	9	63%	20%	17%
5	Pogradec	18	18.02.2022	Hartuar	7	4	2	1	58%	28%	14%
6	Kukës	35	31.05.2022	Hartuar	55	31	17	7	56%	31%	13%
7	Bulqizë	300	01.02.2022	Hartuar	28	15	9	4	54%	32%	14%
8	Lezhë	32	04.04.2022	Hartuar	18	9	3	6	50%	17%	33%
9	Belsh	10	31.01.2022	Hartuar	16	8	5	3	50%	31%	19%
10	Durrës	127	28.10.2021	Hartuar	32	19	7	6	59%	22%	19%
11	Has	44	29.06.2022	Hartuar	41	18	13	10	44%	32%	24%
12	Roskovec	4	27.01.2023	Hartuar	46	28	11	7	61%	24%	15%
13	Pukë	33	03.03.2022	Hartuar	67	42	14	11	62%	17%	16%
14	Kavajë	52	24.05.2022	Hartuar	77	39	6	32	51%	8%	41%
15	Përmet	6	31.01.2022	Hartuar	21	11	6	4	52%	28%	20%
16	Berat	9	02.03.2022	Hartuar	33	20	7	6	61%	21%	18%
TOTAL Masa					635	367	137	131	58%	22%	20%